

URDHËR
NR. 557, datë 28.10.2025

**PËR MBYLLJEN E VEPRIMTARISË SË INSTITUCIONIT ARSIMOR
PARAUNIVERSITAR JOPUBLIK, TË NIVELIT TË ARSIMIT BAZË, SHKOLLA
“DITURIA”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë; të neneve 26 dhe 42, pika 7, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe urdhrit nr. 497, datë 29.9.2025, të ministrit të Arsimit, “Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit, znj. Orjana Osmani”,

URDHËROJ:

1. Mbylljen e veprimtarisë së institucionit arsimor parauniversitar jopublik, të nivelit të arsimit bazë, shkolla “Dituria”, të subjektit juridik “AMK-DITURIA” sh.p.k, me NIPT: K91503006H, licencuar me urdhrin nr. 105, datë 13.9.1999, të ministrit të Arsimit dhe Shkencës, “Për dhënien e lejes së funksionimit të institucionit arsimor jopublik”, i ndryshuar, dhe urdhrin nr. 169, datë 11.7.2002, të ministrit të Arsimit dhe Shkencës, “Për dhënien e lejes së funksionimit të institucionit arsimor jopublik parauniversitar”, i ndryshuar, me kërkesën e tij.

2. Institucioni arsimor parauniversitar jopublik, i nivelit të arsimit bazë, shkolla “Dituria”, ka për detyrë:

a) të kthejë pagesat e kryera nga prindi/përfaqësuesi ligjor i nxënësit për pjesën e papërfunduar të shkollimit, si dhe çdo detyrim tjetër të papërmbushur, nëse ka;

b) të pajisë çdo nxënës me dokumentacionin e nevojshëm shkollor që do të shërbejë për transferimin e tij në një institucion tjetër të arsimit parauniversitar;

c) të vërë në dispozicion të Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Tiranë çdo informacion të kërkuar deri në plotësimin dhe mbylljen e të gjitha kërkesave të parashikuara në këtë urdhër;

d) të dorëzojë në Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar Tiranë të gjithë dokumentacionin lidhur me veprimtarinë e kryer.

3. Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Tiranë ka për detyrë:

a) të ngrejë grup pune, brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij urdhri dhe të marrë masat për mbylljen e veprimtarisë së institucionit arsimor parauniversitar jopublik, të nivelit të arsimit bazë, shkolla “Dituria”;

b) të marrë masa për transferimin e të gjithë nxënësve të regjistruar në këtë institucion arsimor në institucione të tjera të arsimit parauniversitar;

c) të administrojë të gjithë dokumentacionin, lidhur me veprimtarinë mësimore të kryer nga institucioni arsimor parauniversitar jopublik;

d) të ruajë në arkivin e institucionit dhe më tej të arkivojë sipas ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003, “Për arkivat”, i ndryshuar, dokumentacionin e dorëzuar nga institucioni arsimor parauniversitar jopublik, i nivelit të arsimit bazë, shkolla “Dituria”.

4. Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar dhe Drejtoria Rajonale Arsimore Parauniversitare Tiranë të monitorojnë veprimtarinë e Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Tiranë për zbatimin e detyrave, sipas këtij urdhri.

5. Në rast të moszbatimit të detyrimeve nga institucioni arsimor parauniversitar jopublik, i nivelit të arsimit bazë, shkolla “Dituria”, të përcaktuara në pikën 2, të këtij urdhri, Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Tiranë të marrë të gjitha masat, sipas legjislacionit në fuqi.

6. Urdhri nr. 105, datë 13.9.1999, i ministrit të Arsimit dhe Shkencës, “Për dhënien e lejes së funksionimit të institucionit arsimor jopublik”, i ndryshuar, dhe urdhri nr. 169, datë 11.7.2002, i ministrit të Arsimit dhe Shkencës, “Për dhënien e lejes së funksionimit të institucionit arsimor jopublik parauniversitar”, i ndryshuar, shfuqizohen.

7. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore për Arsimin dhe Sportin, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, Drejtoria Rajonale Arsimore Parauniversitare Tiranë, Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Tiranë, institucioni arsimor parauniversitar jopublik, i nivelit të arsimit bazë, shkolla “Dituria”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSMINISTËR I ARSIMIT
Orjana Osmani